V E N D I M
Nr. 167, datë 26.7.2002

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar	i ""
Gjergj Sauli	Anëtar	i ""
Alfred Karamuço	Anëtar	i ""
Kujtim Puto	Anëtar	i ""
Sokol Sadushi	Anëtar	i ""
Kristofor Peçi	Anëtar	i ""

me sekretare Arbenka Lalica e Drita Panda, në datat 20.6.2002 dhe 27.6.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.126 Akti që i përket:

KËRKUES:SHOQËRIA "ORTENSIO" SH.P.K. KAVAJË, përfaqësuar nga avokat Avni Shehu, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. AVOKATI I SHTETIT, përfaqësuar nga zoti Kadri Skera, me autorizim.
2. DEGA E TATIM TAKSAVE KAVAJË, në mungesë.

OBJEKTI:Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.847, datë 25.4.2000 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE:Nenet 42, 131/f, 134/g të Kushtetutës.

Për shfuqizimin e këtij vendimi kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe:

1. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka zbatuar ligjin që ishte në fuqi në kohën e caktimit të detyrimit, por i është referuar ligjit që ishte në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes. Në këto raste, sipas nenit 155 të Kushtetutës, ligjit nuk mund t'i jepet fuqi prapavepruese.
2. Në kohën e caktimit të detyrimit, pullat ishin hequr nga qarkullimi me urdhër të Ministrit të Financave.
3. Në kundërshtim me ligjin e kohës, detyrimi është caktuar mbi mallin e paprodhuar e të pashitur.
4. Në caktimin e detyrimit nuk është patur parasysh çmimi në kohën e furnizimit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Kristofor Peçi, përfaqësuesin e kërkuesit, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Mbi padinë e kërkuesit ndaj të paditur Dega e Tatim Taksave Kavajë, me objekt kundërshtimin e detyrimit fiskal, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Kavajës me vendimin nr.163, datë 13.5.1999 ka rrëzuar padinë. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.419, datë 6.7.1999, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit dhe pranimin e padisë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.847, datë 25.4.2000, ka prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit.

Për të verifikuar pretendimin e kërkuesit për proces të parregullt dhe për të kontrolluar kushtetutshmërinë e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, Gjykata Kushtetuese analizoi rrethanat dhe veprimet konkrete të shqyrtuara dhe të pranuara gjatë gjykimit. Kërkuesi pretendon se detyrimi tatimor, i cili i është komunikuar shoqërisë në datën 26.11.1998, është caktuar në bazë të

ligjit nr.7678, datë 3.3.1993 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet që janë bërë me ligjin nr.8247, datë 2.10.1997 dhe se Gjykata e Lartë për zgjidhjen e çështjes i referohet ligjit të mëvonshëm nr.8437, datë 28.12.1998. Në këtë mënyrë, sipas kërkuesit, detyrimi tatimor i akcizës është në kundërshtim me ligjin, sepse është caktuar mbi mallin e paprodhuar e të pashitur. Por, duke iu referuar ligjit nr.8247, datë 2.10.1997 që përmend kërkuesi, rezulton se për pijet alkoolike, akciza paguhet që me blerjen e pullës, dhe jo pas prodhimit dhe shitjes së mallit, siç pretendohet nga kërkuesi. Kështu, në nenin 2 të këtij ligji përcaktohet: “Për cigaret, purot dhe pijet alkoolike të importuara dhe të prodhuara në vend, akciza do të paguhet me blerjen e pullës”. Këtë rregullim ka bërë edhe ligji nr.8437, datë 28.12.1998, të cilit i referohet në vendim Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Për më tepër, ky kolegj arsyeton se në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, pullat fiskale janë letra me vlerë dhe për to nuk pranohen deklarime për humbjen, dëmtimin apo vjedhjen e tyre.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese çmon se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka zhvilluar proces të parregullt, por ka zbatuar drejt ligjin për zgjidhjen e çështjes dhe nuk i ka dhënë atij fuqi prapavepruese. Detyrimi i kërkuesit për të paguar akcizën parashikohet si në ligjin e mëparshëm të cilit ai vetë i referohet, ashtu edhe në ligjin e ri të përmendur nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit nenit 132/1 të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.